



AKTIVITETET KRYESORE TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE MAJ 2024

DOGANAT, TË ARDHURAT PËR 5-MUJORIN 2024 RRITEN +6.6%

Të ardhurat nga doganat për 5 mujin 2024 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 janë realizuar rreth **5,6 mld lek** më shumë ose **+6,6%**! Në vlerë absolute të adhurat doganore për periudhën Janar-Maj 2024 u realizuan në masën **89,8 miliardë lekë** ose **100,2%** e planit të parashikuar. Treguesi më domethënës për kërkesën e brendshme dhe performancën e të ardhurave janë të ardhurat nga mallrat e akcizës që kanë kontributin kryesor në të ardhurat doganore. Konkretisht për periudhën 5 mujore 2024 janë realizuar **+20,000 ton** karburant, **+47 ton** cigare, **+150 ton** kafe dhe **+220 ton** birrë më shumë se 5-mujori vitit të kaluar.



BOTOHET "LIBRI JESHIL 2023 DHE PRIORITETET 2024"

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave ka publikuar Librin Jeshil "Doganat 2023 dhe Prioritetet 2024", i cili vjen në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Ky është viti i tretë i botimit të Librit Jeshil në formatin e një raporti vjetor mbështetur në vizionin e Administratës Doganore për lehtësimin e tregtisë së ligjshme duke ruajtur ekuilibrin e duhur me analizën e riskut dhe kontrollin pas-zhdoganimit.

"PYETËSORI ME BIZNESIN", DOGANAT MARRIN VLERËSIMET MAKSIMALE

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave ka marrë vlerësimet maksimale në Pyetësorin e dytë të zhvilluar në funksion të rritjes së transparencës dhe në vijim të punës për përmirësimin e shërbimeve doganore ndaj biznesit. Më shumë se **56% e bizneseve** përgjigjen se aplikimet shqyrtohen shumë shpejt dhe mbi 75% e përgjigjeve nënvizojnë se procedurat e deklarimit, verifikimit fizik dhe vlerësimit zgjasin më pak se vitin e kaluar. Vlerësimi për përmirësimet që janë realizuar në procedurat doganore ka qenë pozitiv nga **87.5%** e të anketuarve dhe **mbi 60%** e tyre vlerësojnë si "shumë të mirë" marrëdhënien me doganën. Edhe shërbimet online kanë marrë vlerësimet maksimale nga biznesi dhe procesimi i deklaratare të eksportit dhe importit është vlerësuar nga **55.9%** e bizneseve "shumë i shpejtë".

Përmirësimi i procedurave doganore

14. A vlerësi se ekzistojnë mundësitë për përmirësimin e procedurave doganore?



DREJTORI I DOGANAVE GENTI GAZHELI PRET HOMOLOGUN E MALIT TË ZI VLADIMIR BULAJIĆ

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Genti Gazheli priti në Shkodër drejtorin e Përgjithshëm të Doganave të Malit të Zi, Vladimir Bulajić. Gjatë kësaj vizite zyrtare dy drejtuesit e administratave doganore u ndalën në pikat doganore të **Hanit të Hotit** dhe të **Muriqanit**, dy prej portave kryesore të hyrje-daljeve të qytetarëve shqiptarë dhe malazezë. Gjatë takimit të përbashkët të dy delegacioneve u diskutua për rritjen e bashkëpunimit mes doganave tona të cilat me afrimin e sezonit turistik shtojnë fluksin e udhëtarëve në dy anët e kufirit.



QAFË THANË, PËRGATITJET E FUNDIT PARA NISJES SË SEZONIT TURISTIK

Në Doganën e Qafë Thanës, pika kryesore hyrëse e fluksit të qytetarëve në juglindje të vendit u kryen përgatitjet e fundit para nisjes së sezonit turistik. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Genti Gazheli udhëzoi stafin e kësaj pike të rëndësishme mbi planin e rakorduar të masave të marra ashtu si në çdo pikë doganore.



TIRANË, ZHVILLOHET TAKIMI I PARË TEKNIK MES ADMINISTRATAVE DOGANORE TË SHQIPËRISË, ITALISË DHE GUARDIA DI FINANZA

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Administratave Doganore të Shqipërisë dhe Italisë dhe të Guardia di Finanza, firmosur në 4 Prill në Tiranë, u përmbyll me sukses takimi i parë teknik i programit të bashkëpunimit që do të vazhdojë për një vit. Programi përfshin misionet shtesë në Shqipëri dhe Itali për aktivitete specifike trajnimi, vizita në infrastrukturën portuale të Barit, Ankonës, Triestes dhe Durrësit.



SHËRBIMI 24/7, VIZITË NË DOGANAT E SARANDËS DHE TRE URAT NË PËRMET

Në vijim të ndjekjes nga afër të shërbimit të Administratës Doganore 24/7 Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Genti Gazheli vizitoi Doganën e Sarandës dhe Doganën Tre Urat në Përmët. Në këto pika është shtuar numri i vizitorëve, ndërsa me afrimin e sezonit janë marrë të gjitha masat për të pasur një ambient sa më mikpritës.



DREJTORI I PËRGJITHSHËM NË DEGËT DOGANORE TË TIRANËS DHE DURRËSIT

Në vijim të mbikëqyrjes nga afër të veprimtarisë së Administratës Doganore, Drejtori i Përgjithshëm Genti Gazheli ishte në degët doganore të Tiranës dhe Durrësit. Drejtori i Përgjithshëm theksoi se dogana është në proces drejt digjitalizimit të plotë të shërbimeve brenda qershorit 2024 dhe shmangies së fenomeneve negative për të arritur standartet e unionit doganor evropian.



FILLIMI I SEZONIT, DREJTORI I DOGANAVE NDJEK NGA AFËR PUNËN NË PIKAT KUFITARE TË QAFË-BOTËS DHE KAKAVIJËS



Fillimi i sezonit turistik me shtimin e pasagjerëve dhe mallrave, nga dhe drejt Shqipërisë, është në qendër të vëmendjes së Administratës Doganore Shqiptare. Në prag të festës së Pashkës Ortodokse dhe me kërkesën për shërbimin 24/7, duke lehtësuar lëvizjen e lirë të mallrave dhe pasagjerëve, por duke forcuar analizën e riskut dhe monitorimin, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, pa nga afër punën në doganat e **Qafë-Botës** dhe **Kakavijës**.

DOGANA DIGJITALE

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës E-Albania. Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës proceduriale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit. Vetëm gjatë muajit Maj 2024 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar **634 shërbime online**.

